

Kontakte informacioni

Nëse jeni i shqetësuar për dikë në kishën apo komunitetin tuaj dhe kërkon ndihmë dhe asistencë për dikë më poshtë do të gjeni informacionet e nevojshme për të ndihmuar këta persona në Shqipëri.

Linja falas

**Për informacione dhe mbështetje të viktimave të trafikuar në Shqipëri
08001212**

Ju mund të telefononi falas në këtë numër për të raportuar rastet e trafikimit të personave, nëse ju ndiheni të kërcënuar ose të kërkon informacion për migrim të rregullt.

Policia

Çdo departament policie ka policë të cilët janë të trajnuar për trafikimin. Ju duhet të drejtoheni tek policia juaj lokale për të raportuar situatën dhe të kërkon ndihmë.

12 Komitetet Rajonale të Trafikimit

Këto komitete janë krijuar nga qeveria shqiptare për t'iu përgjigjur dhe adresuar çështjen e trafikimit në nivel lokal. Komitetet janë të përbërë nga njerëz të vendit të cilët punojnë për të adresuar çështjen e trafikimit ose mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë viktimat e trafikimit. Më poshtë jepen kontaktet e sekretariatit të komiteteve për çdo rajon. Nëse dëshironi që të gjeni më shumë informacion në lidhje me këto shërbime në komunitetet tuaja ju mund të kontaktoni për të marrë më shumë informacion.

Faqe Interneti të dobishme

- www.bmsworldmission/intransit.org
- www.chaste.org.uk
(Churches alert to sex trafficking in Europe)
- www.stophtraffik.org (Stop the traffic)
- www.undp.org
(United Nations development programmes)
- www.iom.int
(International organisation for migration)
- www.terredeshommes.org
(Terre des Hommes)
- www.cec-kek.org
(European Council of churches/CEC-KEK)
- www.cec-kek.org/CCMEeng
(Churches Commission for Migrants in Europe/CCME)
- www.unesco.org (UNESCO)
- www.unicef.org (UNICEF)
- www.unhcr.org (UNHCR)
- www.amnesty.org (Amnesty International)
- www.antislavery.org
(Anti-slavery International)
- www.humantrafficking.com
(Human trafficking research and education)
- www.anti-trafficking.net
(International Centre for Migration Policy Development ICMPD)
- www.state.gov
(For Trafficking in persons report released by the office to monitor and combat trafficking in persons, by the US government)

Nr.	Personi i kontaktit	Qyteti	Kontakti
1	Luan Mucaj	Fier	Cel: 069 20 67 883 Tel./Faks: 034 22 488
2	Hajri Bregu	Dibër	Cel:068 27 132 47 Tel.:0 218 2082 Faks:0 218 2631
3	Dorotea Konomi	Vlorë	Cel:068 20 657 27 Tel.:033 231 33 Fax:033 234 47 Prefektura.vlore@hotmail.com
4	Vincens Daberdaku	Shkodër	Cel:069 3037 079 Tel.:022 427 05 E-mail:prefeshk@abcom-al.com
5	Arben Mani	Tiranë	Tel.:04 236 849 Faks:04 240 866 E-mail:amani@icc-al.org
6	Admirim Kongoli	Elbasan	Cel:06822 92 756 Tel.: 05 452 881 Admirimkongoli@yahoo.com
7	Dilaver Tepelena	Durrës	Cel:068 20 60 352
8	Halim Koxhaj	Berat	Cel:069 22 177 96 Tel.: 03 41 41 E-mail:halimkoxhaj@yahoo.com
9	Koço Bello	Korçë	Cel:069 21 09 084 Tel.:082 42 953 Faks:082 440 20 Tel. (shtepi):082 434 74
10	Azem Tema	Kukës	Cel:069 25 154 87 Faks:02 42 23 78
11	Ndrek Mhillaj	Lezhë	
12	Abedin Tushe	Gjirokastër	Cel:069 27 33 647 Faks:08 43 456

Financuan:

"Churches helping Churches"
Fushata e kishave protestante në Gjermani
në fushën e ndihmës ndërkishitare

BESA
Friends of Albania

CHASTE



FONDACIONI FRYMA E DASHURISË
DIAKONIA AGAPES



Shoqëria
Kristiane e të
Burgosurve
të Shqipërisë

TRAFIKIMI i qenieve njerëzore



**Projekti: "Komitetet fetare të krishtera së bashku
në përballjen e trafikimit të qenieve njerëzore"**

Çfarë është trafikimi?

Trafikimi i qenieve njerëzore do të thotë **rekrutim, transportim, transferim, izolim ose marrje të personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo mashtrimit**, abuzim me pushtetin, dhënia ose marrja e pagesës apo përfitime për të pasur nën kontroll ndërgjegjen me **qëllim shfrytëzimin**.

Shfrytëzimi përfshin minimalisht shfrytëzim për prostitucion apo forma të tjera shfrytëzimi seksual, punë e detyruar apo shërbime të tjera, skllavëri apo praktika të tjera të ngjashme me skllavërinë, robërim ose trafik organesh.

Si dhe pse ndodh trafikimi?

Njerëzit trafikohen në mënyra të ndryshme. Shumica prej tyre “rekrutohen” përmes premtimit për punë të mirë, dhe vetëm pastaj e marrin vesh se ata u kanë “borxh” trafikantëve të tyre dhe prandaj janë të detyruar të punojnë për pagë të vogël apo edhe pa pagë fare.

Gratë dhe vajzat e trafikuar rekrutohen shpesh për të punuar në sektorë shërbimi dhe të pritjes, mirëpo i përfundojnë udhëtimet e tyre në prostitucion të dhunshëm, të zëna në kurth nga frika, “borxhi”, vartësia nga droga apo dhuna. Në situata konflikti dhe post konflikti, burrat, gratë dhe veçanërisht fëmijët janë në pozitë të dobët për tu rrëmbyer për qëllime trafikimi.

Trafikimi udhëhiqet nga përfitime jashtëzakonisht të mëdha dhe ka rrezik më të vogël (së paku deri më tani) krahasuar me krimet tjera siç është trafikimi me drogë.

Trafikimi njerëzor është kaq i zakonshëm sa zë aktivitetin kriminal të tretë në renditje pas dograve dhe trafikimit të armëve.

Si funksionon trafikimi?

- Shfrytëzimi seksual (rrugë, bare, bordello, sallone masazhi, sauna, vajzë me telefon, agjenci shoqëruese);
- Puna e detyruar (bujqësi, peshkim, ndërtim, miniera, dyqane rraskapitëse, kuzhina);
- Shërbimi shtëpiak;

- Lypje në rrugë ose shtëpi më shtëpi;
- Shërbimi i detyruar ushtarak;
- Heqje organesh.

Metodat e përdorura për të dëmtuar viktimat:

- **Dhuna** - trafikantët përdhunojnë dhe rrahin viktimat, për ti detyruar të bëjnë atë çfarë kërkojnë ata.
- **Kërcënimet** - kërcënime për të përsëritur dhunën që është përdorur, gjithashtu dhe kërcënime drejtuar pjesëtareve të familjes nga vendi ku erdhi.
- **Shërbim Borxhi** - viktimat bëhen përgjegjës për paratë që trafikantët kanë shpenzuar për to.
- **Kërcënim i ardhur me postë** - mbasi janë detyruar që të prostitutojnë viktimat kërcënohen se do t'u bëjnë të ditur familjeve të tyre se me çfarë realisht po merret fëmija i tyre.

Pse është kjo çështje me rëndësi?

Krimet a lidhura me trafikimin që nganjëherë përfshijnë akte të tmerrshme siç janë arrestimet, dhunimet dhe tortura shkelin të drejtat e njeriut dhe çënojnë sigurinë kombëtare dhe atë ndërkombëtare.

Sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike trafikimi mund të çënojë ndalimin për trajtim jonjerëzor dhe degradues (Neni 7), mbi skllavërinë, robërinë dhe punën me dhunë ose të detyrueshme (Neni 8), si dhe lirinë dhe sigurinë e personave (Neni 9).

Organizatata kriminale trans nacionale të cilat shpesh udhëheqin rrjete të trafikimit po ashtu mund të paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Rrjete të tilla çënojnë shtetet tashmë të dobëta duke i financuar qendrat alternative të pushtetit dhe duke i korruptuar zyrtarët shtetëror në veçanti zyrtarët doganor, të kufijve dhe ata konsullor.

Edhe pse është e vështirë të arrihet me shifra të sakta, është e qartë se trafikimi me njerëz është problem i madh, edhe nga aspekti i shtrirjes gjeografike si dhe nga numri i njerëzve të prekur.

- Të paktën 12.3 milion njerëz janë viktimat të punës së detyruar në të gjithë botën. Nga këto rreth 2.4 milion janë rezultat i trafikimit të qenieve njerëzore (Aleanca Globale kundër Punës së Detyruar, Organizata Ndërkombëtare e punës 2005);

- Trafikimi i qenieve njerëzore është forma më e shpejtë e rritjes së krimit të organizuar dhe që gjeneron rreth 7 billion dollar të ardhura nga kriminaliteti. Madje raporte të ndryshme theksojnë se grupe të ndryshme trafikimi janë duke ndryshuar ngarkesën e tyre nga droga tek trafikimi i qenieve njerëzore në mënyrë që të sigurojnë më shumë të ardhura me shkallë rrezikshmërie më të ulët (Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogën dhe Krimin);

- Në bazë të një studimi të realizuar në vitin 2006 rreth 800,000 njerëz janë trafikuar nëpërmjet kufijve kombëtare që nuk përfshijnë miliona njerëz të cilët janë trafikuar brenda vendit të tyre. (Raporti i vitit 2007 Trafikimi i personave Shtetet e Bashkuara të Amerikës);

- Sipas Interpolit, trafikimi i femrave mund e të jetë \$75,000 deri \$250,000 në vit (Natashas, nga Victor Malarek).

Historik:

Besimet fetare në Shqipëri janë angazhuar për të kontribuar në adresimin e çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore. Në këtë kuadër zyra Diakonia Agapes - Kisha Orthodhokse e Shqipërisë, Caritas Albania - Kisha Katolike e Shqipërisë, SH.K.B.Sh (Shoqëria Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë) nga kishat protestante ndërmorën një iniciativë të përbashkët për realizimin e projektit “Komunitetet fetare të krishtera së bashku në përbashkëtim të trafikimit të qenieve njerëzore”.

Ky projekt konsiston në trainimin e anëtarëve të komuniteteve fetare (orthodhokse, katolike dhe protestante), të cilët më pas do të trajnojnë anëtarë të tjerë të komuniteteve të tyre përkatëse. Këta të fundit do të mobilizohen për të adresuar çështjen e trafikimit si dhe për të ofruar shërbime të ndryshme brenda komunitetit të tyre që kanë lidhje me këtë fenomen.

Grupi i synuar:

Anëtarë të komuniteteve të krishtera fetare, grupet rinore të komuniteteve fetare si dhe komuniteti.